

## Titulli i lëndës: GJUHËSI E PËRGJITHSHME

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Gjuhësi e përgjithshme
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	Viti i II   Semestri i III
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	teuta.abrashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi Gjuhësi e përgjithshme hyn ndër kurset themelore. Ka karakter formues, teorik. Qëllimi kryesor i tij: t'ua bëjë të mundshme studentëve ta njohin objektin e studimit të disiplinës teorike Gjuhësi e përgjithshme (Linguistikë e përgjithshme, General Linguistics), përkatësisht ligjësitë e përgjithshme të funksionimit të gjuhëve njerëzore, mënyrat e studimit të tyre, metodat themelore të studimit në gjuhësi, teoritë më të përhapura në këto studime dhe një ide të përgjithshme për historinë e ideve në këto studime.</p>

Qëllimet e lëndës:	Në këtë kurs synohet <ul style="list-style-type: none"> <li>- përvetësimi i koncepteve themelore lingvistike</li> <li>- përshkrimi i tipareve të gjermanishtes bazuar në njohuritë teorike të përgjithshme</li> <li>- analizimi i aspekteve të ndryshme të gjermanishtes duke zbatuar konceptet teorike të përgjithshme</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të demonstrojë njohuri për konceptet themelore lingvistike</li> <li>- të krijojë një ide më të saktë për vendosjen e dijeve që mund të marrë gjatë studimit të gjuhës gjermane në kuadër të dijes më të përgjithshme mbi gjuhët njerëzore</li> <li>- t'i vendosë ato në kuadër të aparaturës njohëse teorike të përgjithshme dhe t'i bëjë të krahasueshme me dijet për gjuhët e tjera,</li> </ul>

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0,10	15	2,30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	2	2
Detyrë shtëpie	1	15	15

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	7	21
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Total			97,8:25=3,91 4 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, përgatitjes dhe prezantimit të punimeve seminarike, detyrave të shtëpisë.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Kollokviumi i parë (Zwischenprüfung);  Kollokviumi final (Endprüfung);  <b>Provimi:</b> Për ata që nuk tregojnë sukses në kollokviume, do të mbahet provim përmbledhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm me shkrim.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ernst, Peter: Einführung in die synchrone Sprachwissenschaft. Praensverlag, Wien 1999</li> <li>Linke, A./ Nussbaumer, M./ Portmann, P. R.: Studienbuch Linguistik, 5. erw. Auflage, Niemeyer, Tübingen, 2004.</li> <li>Saussure, F. de: Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, përk. R. Ismajli, b. II, Dituria, Tiranë, 2002.</li> <li>Lyons, J.: Hyrje në gjuhësinë teorike, përkth. E. Lika, Dituria, Tiranë, 2001.</li> </ol>
Literatura shpeshë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ducrot, O.–Todorov, Tz.: Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit, përkth. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1984.</li> <li>Hudson, Grover: Essential Introductory linguistics, Blackwell Publishers, Massachussets dhe London, 2000.</li> </ol>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Objekti i studimit të gjuhësisë. Gjuha – fenomen shoqëror. Funkcionet e gjuhës. Gjuha dhe mendimi. Gjuha dhe komunikimi njerëzor. Gjuhësia – shkencë shoqërore.
Java 2:	Historia e mendimit mbi gjuhën. Fillimet e gjuhësisë. Greqia dhe Roma e lashtë. India. Mesjeta. Humanizmi dhe Renesanca. Racionalizmi. Shekulli 18. Gjuhësia si

	shkencë e pavarur – sh. 19. Gjuhësia krahasimtare-historike. Biologjizmi në gjuhësi. Gramatikanët e rinj. Gjeografia gjuhësore.
Java 3:	F. de Saussure dhe strukturalizmi. Shkolla e Pragës dhe fonologjia. Gjuhësia funksionale e A. Martinet-së. Binarizmi i Jakobsonit. Glosematika daneze. Gjuhësia amerikane – Bloomfield dhe blumfildianistët. Gjuhësia gjenerative-transformacionale. Sociolinguistika. Pragmatika. Gjuhësia tekstore.
Java 4:	Procesi i komunikimit: Emetimi i mesazhit; Bartja e mesazhit; Receptimi i mesazhit; Termat e komunikimit.
Java 5:	Shenja gjuhësore. Tre tipa shenjash: indicie; ikona; simbole. Shenja gjuhësore dhe shenja jogjuhësore. Struktura e shenjës gjuhësore: shenjuesi dhe i shenjuari; shprehja dhe përmbajtja; arbitrariteti dhe motivimi; konvencionaliteti; asociativiteti. Vlera e shenjës gjuhësore.
Java 6:	Ligjërim, gjuhë dhe të folur; kompetencë dhe performancë. Nyjëtimi i dyfishtë i gjuhës. Raporte sintagmatike dhe raporte paradigmatiske. Kundërvënie (opozicion) dhe kundërshti (kontrast). Sinkroni dhe diakroni. Relevancë dhe redundancë.
Java 7:	Aparati i të folurit, lëvizja e ajrit dhe prodhimi i tingujve. Nyjëtimi i tingujve. Përshkrimi akustik i tingujve.  Analiza fonologjike. Tingull (fon) dhe fonemë. Tipare dalluese të fonemave. Variante të fonemave. Neutralizim dhe kryefonemë. Ndërlidhni (korrelacione). Theks dhe tone.
Java 8:	Fjala, fjala sintaksore, leksema. Morfema dhe tipet e morfemave. Alomorfi. Monema. Llojet e monemave. Fleksioni.
Java 9:	Derivacioni: rrënja, tema, shtesat (para-, prapa-, ndër-shtesat). Kompozicioni. Analiza e përbërësve të pandërmjetmë.
Java 10:	Pjesët e ligjëratës të gramatikës tradicionale. Pjesët e ligjëratës sipas Heinz Glinz.
Java 11:	Kategoritë gramatikore. Kategoritë parësore, dytësore dhe funksionale. Kategoritë deiktike. Numri dhe gjinia. Veta dhe folja. Rasa. Funksionet gramatikore. Funksionet vendore, parafjalët. Koha, mënyra, aspekti, modaliteti. Ndajfolja. Tipet e gjuhëve: sintetike, analitike, aglutinative, izoluese.
Java 12:	Funksionet gramatikore: kryefjala, kallëzuesi, adjunksioni. Tema dhe rema.

	Adjunksionet dhe komplementet.
Java 13:	Gramatika gjenerative-transformacionale. Metoda hipotetiko-deduktive. Struktura e thellë dhe struktura sipërfaqësore. Rregullat e formimit (PS) dhe rregullat e transformimit (T). Transformimi pësor. Transformimet e përgjithshme.
Java 14:	Semantika. Kuptimi dhe domethënia. Kuptimi denotativ dhe kuptimi konotativ. Kuptimi gramatikor dhe kuptimi leksikor. Teoritë referenciale të kuptimit. Teoritë kontekstuale të kuptimit.
Java 15:	Pragmatika. Teoria e akteve të të folurit. Fjalitë performative dhe fjalitë konstative.

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

